



*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta  
Ministry of Culture, Youth and Sport*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. No:	1318/2023
Data Datum Date	16.03.2023
Nënshtetimi Pajtues Signature	
PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA	



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**ndërmjet**  
**MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**  
**dhe**  
**UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**

## 1. QËLLIMI

Në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Nr.03/81, të datës 01.06.2022), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për konsultimin dhe hartimin e dokumentit narrativ mbi memorializimin e fëmijëve të vrarë gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë. Grupet e konsultimit mbi memorializimin e fëmijëve përfshijnë fëmijët e mbijetuar të vrasjeve dhe krimeve të luftës, prindërit e fëmijëve të vrarë, të zhdukur dhe të vdekur si rezultat i luftës, familjarët e tjerë dhe dëshmitarët e vrasjeve.

## 2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Konsultimi i të mbijetuarve dhe familjeve me fëmijë të vrarë gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë mbi format e memorializimit të fëmijëve përmes një procesi me ndjeshmëri, gjithëpërfshirje, etikë dhe profesionalizëm;
- Ruajtja e tregimeve dhe dokumentimi i përjetimeve reale e të mbijetuarve, të dëshmitarëve dhe të familjarëve të fëmijëve që janë vrarë, janë zhdukur apo kanë vdekur si rezultat i luftës në Kosovë;
- Angazhimi i studentëve me pagesë në projekte shtetërore prioritare për praktikimin e njohurive teorike dhe zgjerimin e aftësive teknike të kuadrove të reja në kulturë dhe trashëgimi kulturore;
- Hartimi i dokumentit narrativ që përshkruan dhe udhëzon memorializimin e fëmijëve mbi të cilën do të bëhet shpallja e konkursit ndërkombëtar për projektin e memorialit të fëmijëve.

## 3. AUTORITETET

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP).

## 4. OBLIGIMET E PALËVE

### Obligimet Ministrisë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS):

1. Mbështetja financiare e projektit me shumën prej 57,000 EUR (pesëdhjetë e shtatë mijë euro) të cilat transferohen nga linja buxhetore e mallrave dhe shërbimeve të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
2. Ndërmjetësimi i komunikimit dhe ofrimi i informacioneve mes UP-së dhe institucioneve publike përmes koordinatorit të Ministrisë, përfshirë komunikimi me mekanizmat si Komisioni Ndërmnistror të themeluar me vendimin e Qeverisë Nr.03/81, të datës 01.06.2022;

3. Prezantimi i gjetjeve dhe promovimi i projektit përmes aktiviteteve të ndryshme, përfshirë format mediatike.

### **Obligimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP):**

1. Emërimi i stafit përgjegjës për koordinimin e zbatimit të projektit të konsultimeve dhe emërimi i stafit përgjegjës për hartimin e narrativës;
2. Konsolidimi i metodologjisë dhe planit dinamik të konsultimeve me familjarët e fëmijëve të vrarë në koordinim të ngushtë me MKRS dhe partnerët e tjerë institucional;
3. Rekrutimi i studentëve të kualifikuar për realizimin e intervistave, mbarëvajtja e modulit të trajnimit për studentët dhe hartimi i udhëzuesit të intervistave, formës së pëlqimit dhe doracakut të praktikave të mira në terren;
4. Realizimi i 150-200 intervistave me grupet e konsultimit dhe audioincizimi dhe transkriptimi i të gjitha intervistave duke ruajtur mënyrën autentike të të folurit lokal dhe nëndialektit (në format elektronik PDF);
5. Hartimi i dokumentit narrativ për konkursin ndërkombëtar për realizimin e projektit të memorialit të fëmijëve përfshirë listën e fëmijëve me informacione përcjellëse, analizimi i të dhënave dhe shqyrtimi i literaturës të mëhershme;
6. Aktivitete të tjera të nevojshme për implementimin e plotë të këtij projekti sipas dakordimit mes palëve (shih pikën 5).

Produktet që dorëzohen nga UP në përfundim të projektit janë: Materialet e përgatitura për trajnim dhe terren për intervistuesit (nënpikat 4-5); Audioincizimet dhe transkriptat e të gjitha intervistave në format elektronik (nënpika 6); Dokumenti narrativ për konkurs ndërkombëtar për memorializimin e fëmijëve, përfshirë listën e fëmijëve me informacione përcjellëse (nënpika 7).

Materialet e grumbulluara dhe të përgatitura nga UP dorëzohen në Komisionin Nderministror të Qeverisë për komente dhe aprovim final.

## **5. ZBATIMI**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” përcjellin implementimin e projektit dhe zbatimin e marrëveshjes dhe udhëzojnë për veprime që duhen ndërmerren në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Memorandumi mund të ndryshojë, plotësohet apo ndërpritet me marrëveshje me shkrim nga të dyjat palët.

## 6. KOHËZGJATJA

Zbatimi i projektit parashihet të zhvillohet gjatë periudhës mars 2023 deri në shtator 2023 për përmbushjen e objektivave. Afati i Memorandumit skadon me implementimin e plotë të projektit dhe aprovimin e Komisionit Ndërministror të Qeverisë.

## 7. KOPJET DHE GJUHËT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në tri (3) kopje origjinale në tri gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## 8. HYRJA NË FUQI


Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

### PALËT NËNSHKRUESE



Hajrulla ÇEKU

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

  
\_\_\_\_\_  
Prof. Dr. Qerim QERIMI

Rektor i Universitetit të Prishtinës

“Hasan Prishtina”

Prishtinë  
më 16 mars 2023